Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/139
Datë: 31.03.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 27.03.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **PËRFUNDON PROCEDIMI administrativ** i filluar sipas kërkesës së Institucionit Qendra për aftësim profesional për te rritur "Katana", me adresë: Rr. "Hasan Prishtina" 360 15000, Obiliq, Republika e Kosovës, me kualifikimin: **Instruktor i armeve te zjarrit, Niveli 4 i KKK me 5 kredi te AAP.**
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Institucioni Qendra për aftësim profesional për te rritur "Katana", me adresë: Rr. Hasan Prishtina, Nr. 360, 15000, Obiliq, ka aplikuar në AKK, për akreditim dhe validim të kualifikimit: Instruktor i armeve të zjarrit.

Me datë 14.10.2022, zyrtarja e AKK-së përmes emalit zyrtar drejtuar institucionit "Katana", ka kërkuar që ta plotësoj aplikacionin dhe të njëjtin me përmirësimet e bëra ta dërgoj në AKK për vlerësim, përmirësimet e kërkuara nga AKK duhet të bëhen brenda 5 ditëve të punës.

Drejtori i institucionit "Katana", në emalin zyrtar të dërguar në AKK ka theksuar se: *"Duke kërkuar ndjesë për vonesën, ju njoftojmë se, për arsye organizative, kemi vendosur të heqim dorë nga kërkesa për akreditimin e programit për Instruktor të armëve të zjarrit. Për këtë arsye, ju kërkojmë që të pushoni shqyrtimin e aplikacionit tonë të dorëzuar lidhur me këtë program".*

Këshilli Drejtues i AKK, duke marr parasysh këtë fakt, se parashtruesi i kërkesës për procesin e akreditimit të institucionit "Katana", e ka njoftuar AKK se kanë *vendosur të heqim dorë nga kërkesa për akreditimin e programit për Instruktor të armëve të zjarrit,* , siç përcaktohet me dispozitat e nenit 103 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***"1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë. 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë".***

Bazuar në këto rrethana, Këshilli Drejtues i AKK-së, lidhur me aplikacionin e institucionit "Katana", pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e AKK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, Qendra për aftësim profesional për te rritur "Katana", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Besim MUSTAFA, PhD,EDBA

~~Kryetar i KD~~ të AKK